

# CREDINS bank

SHOQËRIA TREGTARE  
" BANKA CREDINS " SH.A.

Datë 17.12.2014

## VENDIM

NR. 6 DT. 17.12.2014

### I ASAMBLESË se PËRGJITHSHME TË SHOQERISË 'BANKA CREDINS " SHA.

Sot, me date 17.12.2014, në orën 14:00, në selinë e shoqërisë me adresë në Rr. « Ismail Qemali », Nr. 21, Tiranë, u mbledh Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë BANKA CREDINS SH.A., shoqëri anonime shqiptare, regjistruar në mënyrë të rregullt në Regjistrin Tregtar, me Vendim Nr. 28969, të Gjykatës së Rrethit gjyqësor Tiranë, datë 31.01.2003 (referuar më poshtë si "Shoqëria").

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme iu njoftua të gjithë aksionerëve, në mënyrë të rregullt në respekt të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe Statutit të Shoqërisë, me datën 24.01.2014, me anë të postës së Bankës dhe po atë datë u publikua edhe në faqen e bankës në internet [www.bankacredins.com](http://www.bankacredins.com). Njoftimi u shoqërua në mënyrë të rregullt nga dokumentacioni përkatës i mbledhjes.

Ishin të përfaqësuar në Mbledhje me shume se 50% të Kapitalit të Shoqërisë, e vërtetuar nga Lista e Pjesëmarrjes, e Cila u nënshkrua nga të gjithë të pranishmit. Si konkluzion, Kuorumi i nenit 144 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me më shumë se 50% të kapitalit, është përmbushur. Mbledhja merr vendime me % e aksionarëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

Mbledhja e Asamblesë u drejtua nga z. Maltin Korkuti. Sekretar i Mbledhjes u caktua znj. Dora Vako. Rendi i ditës:

1. Diskutim në lidhje me aksionet e panënskruara nga aksionaret ekzistues të Banka Credins sh.a
2. Propozim për riemërimin e Znj. Monika Milo në pozicionin e zv. Drejtores së Përgjithshme të Banka Credins sh.a.
3. Propozim për miratimin e një shpërblimi vjetor neto për pjesëmarrje në Këshillin Drejtues në masën 10 000 Euro (dhjete mijë euro) për anëtarin e ri, Z. Brett Belcher, (miratuar me Vendim nr.5 datë 29/10/2014 të Asamblesë së Aksionarëve të Banka Credins sh.a). Shpenzimet e udhëtimit cihë të qëndrimit mbulohen nga Banka.
4. Ngarkohet Drejtoria të njoftojë Bankën e Shqipërisë dhe të bëjë regjistrimet përkatëse pranë QKR

**VENDOSI:**

1. Me vendimin nr. 5, date 29.10.2014 te Asamblese se Pergjithshme te Aksionareve eshte vendosur te rritet kapitali i Bankes Credins sh.a. ne masen 10% te kapitalit aktual me emetimin e 5,236,829 (pese milion e dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë e teteqind e njetë e nente) aksioneve me vlere 1 aksion 1.844 USD ose ne euro eshte 1 aksion 1.367 euro. Aksionet e reja iu ofruan per nenshkrim paraprakisht aksionareve ekzistues ne përpjesëtim me pjesen qe zotërojnë ne kapitalin aksionar. Nga totali i aksioneve te emetuara jane nenshkruar nga aksionaret ekzistues nje numer prej 146,306 aksionesh, nderkohe nuk eshte ushtruar e drejta e perparësisë ne nenshkrim dhe kane mbetur pa nenshkruar nje numer prej 5,090,523 aksionesh.

Ngarkohet Drejtoria, te gjeje investitore te mundshem, t'u ofroje per te nenshkruar aksionet e reja ende te panenshkuara, me te njejtin cmim te vendosur me vendimin nr. 5 Date 29.10.2014 te Asamblese se Aksionareve, te ndjeke procedurat e parashikuara nga Statuti cihe Ligji per tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i ndryshuar, per realizimin e plote te qëllimit të mesiperme, ne lidhje me kompletimin e transakcioneve te mesiperme, per te fiksuar modalitetet, per te nenshkruar te gjitha marreveshjet, kontratat etj. dhe me pas per te njoftuar Banken e Shqiperise lidhur me ndryshimet ne strukture, si dhe per te bere regjistrimet perkatese ne Regjistrin Tregtar.


2. Te miratoje rimerimin e Znj. Monika Milo ne pozicionin e zv. Drejtores se Përgjithshme te Banka Credins sh.a.
3. Te miratoje shpërblimin vjetor neto per pjesëmarrje ne Këshillin Drejtues ne masën 10 000 Euro (dhjete mijë euro) per anëtarin e ri, Z.Brett Belcher, (miratuar me Vendim nr.5 date 29/10/2014 te Asamblesë se Aksionareve te Banka Credins sh.a). Shpenzimet e udhëtimit dhe te qëndrimit mbulohen nga Banka.
4. Ngarkohet Drejtoria te njoftoje Bankën e Shqipërisë dhe te beje regjistrimet përkatëse pranë QKR

**AKSIONARËT E SHOQËRISË**

Aleksandër PILO

B.F.S.E Holding BV

Renis TËRSHANA



përfaqësuar nga





Unioni Shqiptar Kursim Kredie

përfaqësuar  
nga

Emi SANTO

Egi SANTO përfaqësuar nga

Monika MILO

Maltin KORKUTI

Ilirjan BUSHATI

Fuad HAXHIYMERI

Arjana SANTO

Kostaq MILO

SIFEM AG

përfaqësuar nga

Sokol Nako 

Neritan DOJAKA

Fadil  
ALLAJBEU

Jorgjia  
BALLI

Leonat KOCO



Viollca BUSHATI

Gjergji BUSHATI